

KOSOVARJA

Ballina: Ardiana Dili

A më shumë
kurorëzime
a shkukurëzime
ndodhin
në Kosovë

Edhe Zoti
vajton për
krimet serbe

**ARDIANA
DILI,**
*ylli
që këndon
me zemër*



Pse frajerat
i qova
në hamam
të Hyrës

Të martohem
me vajzë
fshati a qyteti

Prej se
e tradhtova
burrin
po sillet
mirë me mua

Shtojcë e re:

**Femrat
e arta**





DIMENSIONI
120X278

Mirage
Jewels
NEW

**ARDIANA
DILI,**

*glli i muzikës
që këndon
me zemër*



Ardiana Dili është zë i dashur, artiste e mirënjohur dhe e kërkuar brenda e jashtë vendit. Këndon me zemër e shpirt dhe kjo e bënë të veçantë. Zëri i bukur i estradës ka një mori këngësh e bashkëpunimesh, e shumë të tjera janë duke ardhur.

E dëgjoni, por a e njihni mirë atë dhe jetën e saj? Ardiana Dili flet në “Kosovare” për veten, jetën, muzikën.

Ardianë, tashmë jeni emër i njohur në skenën muzikore. Por, si nisi rruga jote në botën e muzikës?

- Muzikën e kam dashur gjithmonë, që në fëmijëri. Mirëpo, vetëm viteve të fundit më është kthyer nga pasioni në profesion. Tani kjo është fusha ime e jetës dhe merrem vetëm me muzikë, për çka edhe jam mjaft e kënaqur.

Me çfarë emocioneesh e kujton daljen e parë në skenë?

- Me shumë emocione e kujtoj ditën e parë kur kam dalë në skenë. Kam qenë 15 vjeçe kur jam ngjitur për herë të parë në skenën e një festivali folklorik. Edhe sot e kujtoj me shumë kënaqësi dhe do të doja që t'më përsëritej prapë ai emocion e ata lot gëzimi. Më kthyet në kohë, në një prej ngjarjeve më të rëndësishme të jetës sime...

Pas kaq vitesh në muzikë, a ke ende emocione kur je para publikut?

- Ky profesion ngërthen në vete shumë emocion, meqë emocionohesh kur del në skenë, kur interpreton. Sepse, nëse këndon me zemër, me shpirt, me ndjenja, nuk mund të mos kesh emocione.

Keni kryer shkollën e muzikës, por keni studiuar gazetarinë. Pse kjo zgjedhje?

- E vërtetë është se kam studiuar për Komunikim Masiv,

dega e Gazetarisë, për faktin se më pëlqen ky profesion, të cilin do kisha dashur që në të ardhmen ta ushtroj. Gazetaria dhe moderimi më flenë në shpirt.

“Zemër gur” është një nga këngët tua më të njohura. Si lindi kjo këngë?

- Baladat më pëlqejnë, i këndoj me kënaqësi dhe i përshtaten shumë vokalit tim. Kënga me titull “Zemër gur” është pëlqyer jashtë mase dhe jam e lumtur për këtë gjë. Nuk ka ndonjë dedikim të veçantë ose ndonjë arsye për këtë titull. Ideja ka qenë vetëm ta bëjmë një baladë të bukur dhe që do prekë zemrat e publikut.

Çka mendon për ata njerëz që e kanë zemrën gur?

- Njerëzit që e kanë zemrën gur, për mua nuk janë njerëz. Njeriu duhet të ketë zemër të mirë e të madhe.

Të kemi parë e dëgjuar edhe në duete. Ç'thua për këtë?

- Ndër vite kam punuar shumë projekte, e për festat e fundvitit kam pasur edhe bashkëpunime me kolegë të ndryshëm. Nuk do ta kisha cek ndonjërin specifikisht, pasi secili bashkëpunim e ka pasur ëmbëlsinë dhe rëndësinë e vet. Jam falënderuese ndaj bashkëpunëtorëve dhe tekst-shkruesve për të gjitha projektet.

E, me kë e ke peng një duet?

- Do të doja ta kem një bashkëpunim me këngëtarin e mrekullueshëm të skenës sonë muzikore, Sinan Vllasaliun.

E angazhuar gjithandej në dasma e ahengje, apo jo?

- Jam e angazhuar në shumë dasma, sidomos në sezonin e verës. Gjithashtu, kam mjaft mbërme muzikore në vende të ndryshme. Dhe, i gjithë ky angazhim sjell lodhje, por edhe shumë kënaqësi.

Cilën këngë ta kërkojnë më shumë në dasma ose cila e ndezë atmosferën më tepër?

- Disa këngë e ndezin atmosferën, e qojnë në një nivel tjetër. E bëj më të mirën time në çdo dasmë, andaj edhe atmosfera përherë është në kulmin e saj.

A të lodhë ndonjëherë gjithë ky aktivitet në botën e muzikës?

- Kur ka dëshirë e vullnet, nuk ka mund e lodhje. Unë këndoj me zemër.

Ndonjë projekt i ri?

- Së shpejti do i realizoj disa projekte, të tjerat do të vijnë në të ardhmen e afërt. Pra, kam mjaft risi.

Jeta jote jashtë muzikës?

- Shumë e mirë... (qesh).

Një dëshirë e parealizuar?

- Kam dëshira të parealizuara, por të cilat do të realizohen në të ardhmen, pasi punoj shumë në këtë drejtim. Gjithsesi, shëndeti në rend të parë...

Pasioni i fshehtë?

- Vallëzimi dhe gatimi. Nuk e dinë shumë njerëz, por janë pasionet e mia të mëdha.

Për fund?

- Faleminderit Revistës suaj, "Kosovarja", për mbështetjen e vazhdueshme. Ishte kënaqësi të realizonim këtë intervistë...

Nderim Neziri



Çka po ndodh me martesat në Kosovë?

Vitin e shkuar *1569*shkurorëzime në Kosovë!

Ditë më parë nga Agjencia e Statistika-ve të Kosovës u dha shifra se 1343 shkurorëzime kanë ndodhur vitin e shkuar në Kosovë nga muaji janar deri në fund të muajit tetor, që do të thotë se në nëntor e dhjetor ka pasur edhe shkurorëzime të tjera dhe shifra deri në fund të vitit arrin në 1569 sosh.

Pa dyshim, ndarja e çifteve në Kosovën e pasluftës po ndodh me të madhe, e sidomos viteve të fundit. Një numër i madh i çifteve janë shkurorëzuar vetëm vitin e shkuar dhe po shkurorëzohen edhe shumë çifte të tjera.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2021 flasin për 2160 shkurorëzime. Ndërsa, të dhënat për vitin 2022, saktësisht për dhjetë muajt e parë, pra nga janari deri në fund të tetorit janë 1343 shkurorëzime, e që në fund të vitit shifra e shkurorëzimeve në Kosovë arrin në 1569.

Mosha që më së shumti ka pasur shkurorëzime gjatë vitit të kaluar ka qenë mosha prej 25 deri 29 vjeç. Pra, kemi të bëjmë me një moshë të re, e cila nuk ka arritur t'i forcojë themelet e krijimit të familjes. Numri më i lartë i shkurorëzimeve, sipas vendbanimit të përhershëm në komunë dhe kohëzgjatjes së martesës për vitin e kaluar, ishte komuna e Prizrenit me 189 shkurorëzime.

PSE ÇIFTET E RINJ SHKURORËZOHEN?

Në këtë pyetje më së miri mund të përgjigjen sociologët dhe psikologët, por është fakt se prishja e kurorës nga çiftet po ndodh me të madhe. Dhe, për të marrë një vendim të tillë, pa dyshim, nuk është edhe lehtë. Arsyeja, sipas sociologëve, në radhë

të parë është xhelozia, pastaj vijnë problemet ekonomike, e kështu me radhë...

Ndërkaq, sipas psikologëve, depresioni është njëri ndër shkaktarët kryesor të ndarjes së çifteve.

Por, nuk duhet përjashtuar as arsyen se disa burra po përdorin dhunë në familje, kështu që rehatia në familjet tona po lëkundet.

Në anën tjetër, disa raste që ndodhen te ne në Kosovë, e që burrat i mbytnë gratë e tyre, veç sa i kontribuon këtij fenomeni, i cili sa vjen e po shtohet.


SI TË PARANDALOHEN SHKURORËZIMET NË KOSOVË?

Në këtë drejtim kontribut të madh mund të japë Qeveria, duke i ndihmuar çiftet e rinj me vende pune, me sigurimin e banesës, e të tjera të ngjashme.

Ndërkaq, edukimi në familje mund të jetë një bazë e mirë e qëndrueshmërisë së jetës bashkëshortore. Sepse, në familjet me edukatë dhe tolerancë, pa dyshim, ka më pak shkurorëzime.

Isa Ilazi

A HARROHET BURRI I MADH I KOSOVËS PROF. ZEKERIA CANA?



Janar i këtij motmoti. Çuditërisht, janari është muaji në të cilin kanë vdekur njerëzit, personalitete të mëdha të kombit tonë, të historisë sonë...

Disa prej personaliteteve që kanë lënë gjurmë të thella me vlerë, qoftë në atë publicistike, letrare, shkencore, por edhe që e flijuan veten, derdhën gjakun për këtë tokë, për këtë komb, për këtë Kosovë, për lirinë e popullit të saj, përkujtohen në disa medime apo edhe me ndonjë akademi përkujtimore.

Por, në këto raste, të shkon në mendje pyetja: Pse në gjithë këto kujtime e përkujtime disa emra të njohur nuk përkujtohen fare? Madje, as në përvjetorët e tyre të vdekjes! Kalojnë në heshtje, pa asnjë lajm, pa asnjë jehonë, siç u bëhet disa të tjerëve...

Dhe, mendja më shkon te Zekeria Cana.

10 janar i këtij motmoti. Shfletoj faqet e portaleve tona të kësaj dite. Asnjë fjalë për prof. Zekeria Canën në shenjë përkujtimi. Në mbrëmje përcjell edhe ekranet televizive, lajmet... As ato asnjë fjalë për profesorin e nderuar, burrin e madh të Kosovës.

Madje, nuk e kujtojnë as shokët, as kolegët e vet të Institutit Albanologjik, ku punoi e veproi shumë vjet!

Virtytet e prof. Canës do të kujtohen dhe do të nderohen përherë nga qytetarët e Kosovës, për lirinë e të cilëve i shkoi e gjithë jeta – thoshin pushtetarët në telegrame ngushëllimi ato ditë kur ai vdiq.

Por, nga ato ditë e sot, prof. Cana sikur u harrua... U harrua njeriu i cili në dy dekadat e fundit të shekullit XX qe bërë simbol i rezistencës ndaj dhunës, përndjekjeve, tmerreve dhe vrasjeve të shqiptarëve.

Pra, a nuk është turp të mos kujtohet ky vigan i historisë shqiptare, ky patriot i madh që shkriu gjithçka për popullin e Kosovës?

Ai, kush tjetër e meriton të përkujtohet?

Ai, i cili ishte në ballë demonstratave kundër pushtetit serb, në ballë të skenave për Pajtimin e Gjaqeve krah Anton Çettës, në konferencat e shtypit krah Ibrahim Rugovës dhe për 39 burgosjet e tij...

Përgjatë shoqërimit me të, goxha kohë, meqë e kisha edhe bashkëpunëtor të Revistës, derisa i shkruaj këta pak rreshta, seç më kujtohen fjalët e tij, kuptimplote, të cilat vlen të mbetën edhe si thënie nga përvoja e tij jetësore:

“Në dhimbje të vjen miku, në gëzime të njohurit, kurse në vdekjen tënde vijnë edhe armiqtë”. Këto fjalë të tij thuajse tregojnë edhe testamentin që e kishte lënë për një ceremoni modeste të varrimit, pa fjalime e pa ceremoni fetare...

Ju kujtojmë se si rezultat i përballjeve të shpeshta me forcat policore serbe, profesori, në mesin e popullatës, ishte bërë sinonim heroizmi e qëndrese heroike me guxim të trimërinë e rrallë.

Profesor Cana ishte ndër të parët që ngriti zërin kundër vrasjeve të ushtarëve shqiptarë në ish-Armatën Jugosllave, duke hequr të gjitha maskat e terrorit ushtarak serbosllav ndaj shqiptarëve.

Thuajse të gjithë ata të rinj shqiptarë të vrarë nga ish-Armata jugosllave i varrosi me dorën e tij, në tokën gjithandej Kosovës.

Në momente të vështira u gjet edhe pranë familjes Jashari në Prekaz. Ai me dorën e tij e varrosi edhe Adem Jasharin, bashkë me familjarët e tij dhe të tjerët nga masakra makabër, e një sakrifice unike në botë.

Profesori qëndroi besnik dhe ndau fatin me popullatën e pambrojtur edhe gjatë bombardimeve të NATO-s.

E, përkundër rreziqeve të mëdha e të shumta, çlirimin e Kosovës e priti në shtëpinë e vet...

Pas çlirimit kontribuoi në konsolidimin e shtetit të Kosovës, por asnjëherë me synime për poste...

U largua nga kjo botë, para 14 vjetësh, ashtu siç largohen njerëzit e mëdhenj, me virtyte të larta njerëzore e patriotike.

Ndjehem shumë i privilegjuar që kam pasur fatin të shoqërohem me të, në terren, gati në çdo cep të Kosovës...

Të shumtat biseda e përjetime me të i kam përmbledhur në librin “Madhështia dhe tragjika”, të cilin e kam botuar sa profa ishte gjallë.

Andaj, është e çuditshme se si ky njeri kolossal ka mbetur një nga figurat më të anashkaluara nga harresa institucionale, mediale dhe shoqërore e popullit tonë!

Dhe, në fund, a nuk e meriton i madhi Zekeria Cana ta ketë një shtatore krah bashkudhëtarit të tij – Anton Çettës?

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

A më mirë me u martua me një vajzë të fshatit a të qytetit?

Vajza e qytetit lypë me e dërguar në kafiqa! E, ajo e fshatit di me zier pasul dhe me larë e pastruar në shtëpi...

BESIANA MURTURI:
DISA FSHATARE MË TË QYTETËRUARA SE QYTETARET!

- Ka femra që jetojnë në fshat, por janë 100 herë më të qytetëruara se ato që jetojnë në qytet, kështu që qytetërimi nuk varet se ku jeton po çfarë karakteri e kulture ke...

MIHRIE AGUSHI:
EDHE PSE JAM FSHATARE NUK UA LËSHOJ RRUGËN FEMRAVE TË QYTETIT

- Jam e lindur e rritur në fshat. Kam kryer shkollën e mesme dhe punoj në qytezën time. Nuk ua lëshoj fare rrugën vajzave të

qytetit, sepse kam edukatë të mirë, e moralshme po, e arsimuar po, e punësuar po.

FIDAIM AZIZI:
DISA FEMRA NUK E DINË AS VETË SE KU ËSHTË MË MIRË!

- Gruas që thotë se jeta e qytetit është më e mirë se e fshatit, i shes dardha t'kalbta t'fshatit dhe ajo më falënderohet! Pra, nuk ka haber nga jeta. Sepse, sot për sot, jeta më e mirë është në fshat sesa në qytet, si me ajrin e pastër, rrugët e asfaltuara, shkollën afër, shtëpinë e shëndetit në qendër të fshatit, nga një a dy vetura i ka secila shtëpi, e shumë të tjera të mira që nuk e shoh të arsyeshme t'i them.

BLERIM XHIMSHITI:
QYTETI PËR PUNË E SHKOLLIM ËSHTË MË I MIRË

- Qyteti për punë e shkollim është më i mirë se jeta në fshat. Por, edhe fshati i ka të mirat e tij. Hapësirë dhe ajër të pastër po, ara ku mund të mbjellësh do gjë që i nevojitet njeriut, oborr për kopsht e lule sa të duash, livadhe me lule si në Perëndim. E, çka jo tjetër?

PËR FUND

Dikur njerëzit e lëshonin fshatin dhe vendoseshin në qytet për një jetë më të mirë. Por, sot jetë më të mirë, pa dyshim, bëjnë fshatarët.

Diturie Haxhaj

Start the **DAY** **RIGHT**



Aleksandër Moisiu, Uji i Ftohtë, Vlorë, Shqipëri 9405

www.marinabay.al | info@marinabay.al | +355 69 604 1000

“Edhe Zoti vajton për krimet që Serbia i kreu në Kosovë!”

“Edhe Zoti vajton për krimet që policia e Serbisë i ka kryer në Kosovë”, thotë ish-polici serb Vlladimir Markoviq.



Ish-polici serb Vlladimir Markoviq

“Nuk kam mundur të durojë që një ditë të shkojë në varr e bashkë me të të varrosët edhe e vërteta për krimet e kryera ndaj shqiptarëve, e për të cilat isha dëshmitar”, thotë për emisionin “Udhëve”, Vlladimir Markoviq, ish-pjesëtar i policisë së Serbisë, i cili gjatë luftës në Kosovë ishte dëshmitar i krimeve të kryera nga shteti i tij ndaj shqiptarëve.

“Jam Vlladimir Markoviq, nga Varvarina e Serbisë, polic i pensionuar. Ka punuar në stacionin policor në Varvarinë. Por, gjatë kohës së luftës në vitin 1998-1999 kam qenë në rrethinën e Suharekës dhe në Suharekë.

Në Kosovë kam qëndruar 3-6 muaj dhe më së shumti kam qëndruar në Prishtinë, Pejë, Klinë, Gjurakocv dhe Lipjan.

Kam qenë pjesëtar i policisë që nga viti 1987, polic i rregullt dhe nuk kam qenë në njësi speciale dhe as nuk kam marrë pjesë në asnjë aksion të armatosur dhe as diçka të tillë.

Në Kosovë kam parë shumë vjedhje që kanë ndodhur nga policët lokalë. Personi me nofkën “Bosanac” kam dëgjuar se vrasjet i ka bërë në rrethin e Suharekës me rrethinë. E, çfarë ka ndodhur me të tutje nuk e di.

Disave na kanë kthyer në Duhël. Në Duhël na kanë vendosur në një shtëpi të një shqiptari dhe aty kam qëndruar një muaj deri në nënshkrimin e marrëveshjes së paqes, e mendoj se kjo ka qenë me datën

10 qershor.

Ditën tjetër ka ardhur urdhri që pasdite ta presim autobusin me policët e tjerë nga Suhareka dhe të kthehemi në shtëpi, në Serbi.

Në orët e hershme të mëngjesit të datës 12 qershor UÇK-ja e ka marrë Suharekën dhe e ka marrë edhe autobusin me të cilin ne është dashur të kthehemi në Serbi. Në atë autobus kanë mbetur dokumente të ndryshme, letërnjoftime dhe uniforma, ndoshta edhe gjëra të tjera që i kishin vjedhur.

Neve na kapi paniku se, normalisht, oficerët e lartë kanë hipur në xhipa, kurse neve na lanë në mëshirë të fatit.

Aty kemi qenë 20 policë dhe 12 ushtarë të rinj. Në një moment në radiolidhje kemi dëgjuar luftëtarë të UÇK-së, sepse radiolidhja jonë më nuk ka punuar. Andaj, na kapi paniku se si do të kthehemi në Serbi. Aty ishin disa kamionë dhe një fugon i mbyllur me ngjyrë të bardhë. Jam munduar ta hap derën e pasme të tij. Aty kanë qenë disa persona me uniforma. Nuk më kujtohet a kanë qenë ushtarë apo policë. Kur i kam pyetur a të hyjmë në atë fugon, në mënyrë që të shpëtojmë dhe të shkojmë në Serbi, ata në mënyrë arrogante na kanë refuzuar dhe na kanë thënë të largohemi nga ai kamion.

Një ushtar na ka parë se jemi frikësuar dhe na është ofruar dhe ka thënë se nuk mundemi të hyjmë në atë kamion për shkak se aty ka trupa të shqiptarëve civilë.

Tutje, nuk di cili nga rezervistët e ka ndezur një kamion të shqiptarëve, pronari i së cilit ka qenë vozitës i zhavorrit dhe jemi renditur në kolonë.

Kamionin fugon e kam përcjellë dhe ka qenë larg nga kamioni ynë ndoshta 50-100 metra. E, kur e kemi kaluar ndarjen, veçse ka filluar të errësohet.

Në Krushevc kemi arritur në ndërtesën e zjarrfikësve në orët e mbrëmjes, pastaj kanë ardhur nga SUP-i i Varvarinit dhe ne kemi shkuar në shtëpitë tona.

Pas 20 ditësh apo një muaj kam shkuar në atë ndërtesë të zjarrfikësve dhe kam dashur të marrë dokumente nga Sekre-

tariati i Suharekës, sepse aty kanë qenë dosjet për të gjithë personat e komunës së Suharekës.

Në atë moment e kam vërejtur aty kamionin fugon me ngjyrë të bardhë, ku me fjalët e atij ushtarit a policit, në të ka pasur trupa të shqiptarëve civilë.

Më datën 1 gusht 2000 kam marrë një vendim që të shkoj në Bujanovc. Dhe, po në të njëjtën ditë, derisa kemi pritur për të hipur në fugon, kam dëgjuar bisedën nga disa policë, të cilët shikonin në drejtim të atij kamionit-fugonit me ngjyrë të bardhë. Kam dëgjuar nga ta se trupat e pajetë të shqiptarëve i kanë varrosur në vendin “Naumpare”, në poligonin e ushtrisë, 25 km në afërsi të Krushevcit. Kam dëgjuar se në atë vend janë varrosur trupat e pajetë të rreth 20 shqiptarëve civilë nga rrethina e Suharekës dhe Rahovecit, por nuk di a kanë qenë gra apo burra.

E, ato që i kam parë unë i kanë parë ndoshta edhe 100 policë të tjerë.

E, pse po i tregoj tash, 21 vjet pas lufte? Po i tregoj që të ndjem më lehtë dhe do më lehtësohej shpirti, sepse unë i kam parë, po e them të vërtetën.

E, atë çfarë kam parë në Kosovë, siç e përmenda në vitin 1999, me nga 3-4 apo 6 muaj sa kam qenë, Zoti vajton për ato çfarë kanë bërë policët e Serbisë dhe oficerët e lartë ndaj civilëve shqiptarë dhe popullit të rëndomtë.

Në vitin 1999, afër hotelit “Ballkan” në Suharekë, ka qenë një lagje luksoze me shqiptarë. Një pasdite ka ardhur një njësi speciale, nuk e di se nga kanë ardhur apo a kanë qenë policë aktivë apo rezervistë dhe kanë filluar ta djegin atë lagje të shqiptarëve.

Të nesërmen shqiptarët nga ora 6 e mëngjesit janë vendosur në një shkollë, në afërsi të hotelit, diku afër 100 metra dhe rreth orës 7 deri 7.30 ne i kemi dëgjuar britmat dhe kemi parë duke u djegur ende ajo lagje. Aty kanë filluar me një breshëri të të shtënave.

E, a ka vdekur dikush apo është vrarë, nuk mund ta di saktë, nuk më kujtohet a ka pasur viktimë civilësh”.

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



remos_restaurants

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

Ma jep një mindil që t'ia marrë erën tënde!

Cani, në vitet 60, ishte djalë i ri. E donte fqinjën e vet, Tixhen, me gjithë shpirt. Dhe, atëherë e tash nuk dashuroi më kurrë, edhe pse tash është i martuar me Mihanen dhe i kanë katër fëmijë, të rritur, bërë burra...

Cani, kur ishte 20 vjeç, e kishte kohën për të gjetur fatin e jetës. Një nuse që do e gëzonte shtëpinë.

Ai e punonte tokën. Me mexhën e arës së tij lidhej ara e fqinjit. Mihanja, fqinja e arës, e shikonte Canin me një sy krejt tjetër nga të tjerët...

Ajo do t'i bënte të ditur Canit se e donte, por nuk mund t'ia thoshte me gojën e vet, se shpirti i saj digjej për të...

Dhe, kur Mihanja punonte në arë, Cani dembelosej, duke e ngritur kokën kah ajo dhe duke u ankuar se ishte lodhur shumë...

Por, edhe Mihanja nuk rehatohej, duke e kthyer kokën orë e çast kah Cani.

E, dashuria e saj vërehej edhe nga kalimtari i rastit...

Dhe, po ta dinte familja se ajo e donte fqinjin, do e jepnin sa më larg katundit të tyre, duke ia gjetur burrë cilindo qoftë.

Gjatë gjithë ditës ajo punonte në arën e vet, afër arës së Canit, deri kur hëna veç fillonte të ndriçonte...

Një mbrëmje vere, Mihanja në mbrëmje i lë Canit një letër nën gurin e mexhës.

"Ti, që po ma merr shpirtin çdo ditë e më shumë, mezi po pres ta lexosh letrën time! Kur e lash letrën nën guri të mexhës, mu bë se më pa baba dhe desh vdiqa nga frika! E, që të mos dyshojë gjë, i mëshova gurit me shati, kinse për t'ia shkundur baltën... Nuk jam duke ardhur në arë që ta ndihmoj edhe aq babën. Arsyeja kryesore pse vij në arë je ti.

Ma ke marrë gjumin! Zgjohem herët në mëngjes dhe mezi pres të vij në arë!

Nëna gjithnjë më pyet se a ka edhe dikush që punon në fushë afër jush, por

unë bëhem sikur nuk di se kush është afër nesh! Sepse, po t'ia them nënës që je ti, menjëherë i thotë babës se çika po do burrë!

Po frikësohem se do më japin diku larg, në Jezerc. Po më kërkojnë atje që një vit, por diçka nuk ishte në rregull me ta dhe ndoshta po shpëtoj!

Të kesh kujdes kur t'ma kthesh letrën! Mos e lë më nënë guri, sepse babai do e kuptoj pse po sillem kah guri... Letrën lema nënë kungullin e madh, e që gjendet afër gurit. Se, po mori vesh baba se po merremi me letra, ma the kryet shati!

Mbrëmë të kam pa në ëndërr, sikur m'kishe dërguar mesitët. Por, njëri prej tyre nuk donte të kryente punë pa i dhënë para...

A thua, çfarë kuptimi ka kjo ëndërr? Pyete loken tënde, ndoshta ajo e di. Dje e pash kah fliste me babën dhe pak fjalë që i dëgjova ishin se ajo i tha - t'u ka rritë çika...

Kam qejf të të takoj edhe para se të bie në gjumë, por nuk di si do të dalë jashtë shtëpisë...

Më duket se nesër baba dhe nëna shkojnë te dajat, e unë në mbrëmje mund të dal në çardak dhe ma bë me dorë nga larg...

E, nëse ta bëj me të dyja duart, dije se jam vetëm...

I lutem Zotit të na bashkojë!"

BUKUR PO TË RRINË KULET E REJA!

"E kam marrë letrën tënde mbrëmë dhe jam mërzitur shumë që po të lypin ata, Bajraktarët. Unë nuk heq dorë prej teje...

Dje, në ara, bukur të rrinin kulet... Ishe e mahnitshme... Nuk më hiqet merakun për ty nëse të japin. Por, do gjejmë një dalje dhe do i flakim lotët. Do të të grabis tek e fundit...

Kemi ku të shkojmë nëse vjen puna deri aty...

Kam fol me dajën. Më ka thënë se mundemi me shkua te ai naj ditë, derisa të merren vesh burrat. Nuk mendoj se zgjat shumë pajtimi, sepse baba yt nuk është njeri i keq.

Kur të pash dje në arë, m'u duk se ia more rrezet diellit! Më shumë më ngrohe ti sesa dielli!

Natën edhe mua më ka ardhur zëri yt...

E kam frikën e Bajraktarëve se janë të fortë ata. Kam dëgjuar se i kanë prem-

tuar mesitët para të majme dhe ai çdo ditë po troket në derën e tyre...

Ofrohu kah lokja, se te ajo ke me e gjet shpëtimin! Mbështjelle letrën me mindil, që t'ia marrë erën tëndel!"

RUAJE MINDILIN E DASHURISË!

"Sot baba është sëmure diçka... Më duhet të vij në arë vetëm, ose me vëllanë e vogël. Mindilin ta jap për me të tregu se jam e jotja dhe e askujt tjetër. Por, nëse më japin me zor te Bajraktarët, nuk kam rrugë tjetër..."

Natën i dëgjova nënën dhe babën kah flitnin. Nëna nuk pajtohej të fejohej për burrin e Bajraktarëve. Por, baba kishte qejf. Ndoshta i kanë fol pare...

Oh, Zot, sa shumë u mërzita pastaj...

Dhe, mendova të iku me ty...

Pra, të ikim sa më shpejt, para se t'më japin për Bajraktarët!

E di se lokja më do dhe po mundohet të mos më fejojnë pa dëshirën time...

Bile, e ka quajtur nënën time kudër që nuk po reagon edhe më ashpër kundër fejesës sime që po vjen...

Nëse më fejojnë për Bajraktarët, më duhet me e përbirë një kerr me thera...

Jeta ime do të shuhet si dielli kur perëndon...

Jam e mërzitur, o Can! Nuk po më zihet vendi-vend kur po mendoj se mund të mos bëhemi bashkë.

Sot, e hutuar kam hyrë mbathur në dhomë dhe i kam lënë fërkemët...

Pastaj, shpejt e shpejt i kam larë, sepse do më thoshin - ku i kam mendtë..."

NUK DO TË MARTOHEM ME ASKËND TJETËR!

"Shpirti jem, mindilin e mora dhe do e ruaj tërë jetën. Nëse të qojnë me zor te Bajraktarët, unë do të martohej me mindilin tënd!

Mindili që ma dhurove do ma kujtoj fytyrën tënde, lotët tu, mallin për ty... Në të po i shoh sytë tu të zi, shpirtin tënd...

Nuk do të martohej kurrë me dikë tjetër, edhe pse baba po këmbëngulë se e kam kohën për martesë, kurse nëna, paksa e sëmure, ka nevojë për dikë që e ndihmon në punët e shtëpisë...

E dashura ime, më duket se asgjë tjetër nuk flitet në familjen tënde veç se si me të fejuat ty!

E, unë, nëse fejohej e martohej ti, si do jetoj?!

Çka do më duhet jeta?!"

Sokol Murturi

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

Burrin e kam ashiqare homo!

*Jam munduar me qenë
vajzë e mirë në familje.
Shumë kënaqësi të jetës
ia kam ndaluar vetes
vetëm e vetëm që të mos
ua marrë fytyrën familjes.
Por, kam pësuar...*

I DASHURI I PARË ISHTE KATASTROFË!

Kur e kreu shkollën e mesme u njoha me një djalë. S'dua me hy shumë në detaje, por ishte njeri katastrofë dhe më pruri në 40 kg. Ma gërditi jetën. Por, deshi Zoti e u largua nga unë dhe, thashë me vete, shpëtova... Sidoqoftë, pas një kohe e rimora veten, fillova me shtuar peshë, me i harruar të këqijat, me jetuar jetën...

I DYTË

EDHE MË KATASTROFË!

Ndërkohë në "Facebook" u njoftova me një djalë që jetonte jashtë Kosovës. Ishte i bukur, fliste mirë. Kështu, nisi t'ma zbulonte jetën. Më bëri me i harruar të këqijat... Thashë, shqyr Zotit që ma solli një kësi melaqe! Dhe, teksa flisnim çdo ditë në telefon dhe me kamerë, një ditë, teksa qeshnim ndërmjet veti, i hyri dikush në banesë. Ishte një mashkull i moshës së tij. I thashë: "Qysh hyn njeri në banesë pa trokitur fare?!" Por, ai nuk deshi të bisedonte në këtë temë... Sidoqoftë, vazhduam të flisnim çdo ditë, madje deri kah gjyja e natës... Dhe, erdhi koha e u fejuam. Por, kur i thosha të kurorëzohemi që ta merrja vizën e të shkoja te ai, disi e kapte një stres, një nervozë...

Andaj, nisa me dyshuar në të...

E, kur erdhi herën e parë në Kosovë, më tha se do të bëhemi kurorë verën tjetër.

Dhe, kaluan dy vjet e kurrëgjë...

Por, një natë, teksa bisedonim, më tha: "Nuk mund të kurorëzohemi, sepse unë jam i kurorëzuar me një burrë, sepse ndryshe nuk ma lejonin lejeqëndrimin". Andaj, fjalët e tij më qitën në nokaut dhe s'mund të besoja se ai, me të cilin flisja çdo ditë për një bashkim me të, është homo!

Kështu, që nga ajo ditë jam mbetur në udhëkryq.

Familjes s'po kam guxim me u treguar se po frikësohem se mos do bëjnë zhurmë me familjen e tij, e që ka kohë që i njohin.

Andaj, jam në gjendje shumë të keqe shpirtërisht dhe psikikisht dhe po mendoj se kurrë në jetë për mua mirë s'ka me u bërë...

Venita, Prizren

SUANITA

High End Luxury



SUANITA High End Luxury ofron produkte ekskluzive dhe unike nga të gjitha markat luksoze !

Parimi ynë mund të përkufizohet si:

MË E MIRA PËR MË PAK: Gjithmonë ofrojmë cilësinë më të mirë për çmimin më të mirë.

CILËSI E GARANTUAR: Ofrojmë vetëm produkte të cilësisë më të lartë, premium në çdo deitaj (imzim i klasës së parë !)



Dikur unë, tash ata mua...

Krejt frajerat që i kam pasur i kam quar në hamam të Hyrës!

Krejt frajerat i kam pasur të mirë dhe vetë i kam lënë. S'ka guxuar kush me ma prish qefin se për pak i qoja në hamam të Hyrës...

Jam 25 vjeçe nga Mitrovica. Por, çfarë kam përjetuar në jetë më duket si me i pasur 50 vjet. Jeta ime e dashurisë nis qëkur isha në klasën IX të fillores. Dhe, kur dola në klasën X, ja nisa hajt me njërin e hajt me tjetrin... Por, më besoni, krejt frajerat i kam pasur të mirë dhe kam luajtur me ta qysh kam dashur vetë. Me ma prishur tymin e duhanit asnjë s'ka guxuar, sepse i kam quar në hamam të Hyrës. Mirëpo, kur u ngopa me frajera dhe mendoja ta gjeja një djalë serioz për martesë, për të krijuar familje, ma ktheu Zoti shumë keq...

JAM NË LIDHJE ME NJË ZHYLLAN!

Tash jam në lidhje me një djalë 31 vjeç dhe, thënë të drejtën, kurrë s'ma ka marrë mendja se vjen puna që të dashurohem në një zhyllan si ai. Madje e dashuruar, siç thuhet, nga shkronja A deri në Zh. Por, s'di nga kush ka mësuar për frajerët e mi dhe tash po luan me mua si macja me miun... Prandaj, kam ardhur në përfundim se më dënoi Zoti për të gjitha të këqijat

që ua bëja frajerave të mëparshëm, kur për një fjalë jo të mirë i qoja në hamam të Hyrës!

E, tash, siç thashë, kam ardhur në pozicionin "mat"! Me e lënë nuk po mundem, sepse jam dashuruar marrëzisht në të, si kurrë më parë.

Por, edhe të martohem me të e di se do më kritikojnë familje se ku e gjeta mu atë zhyllan...

Andaj, Zoti më ndihmoftë se jam kah luaj me mend...

Venita, Mitrovicë

★★★★★
BREZOVICA
HOTEL & SPA

When snow falls
nature listens.

Prej se e tradhtova burrin po sillet mirë me mua!

Prej se e tradhtova burrin po sillet mirë me mua, më duket se i dhashë mend..

Jam një grua ferizajase. Vuaj natë e ditë për gabimin që e kam bërë, me mëkatën që nuk ia fali dot vetes. E tradhtova burrin, sepse asnjëherë s'më ka qëndruar pranë, s'është kujdesur kurrë për fëmijët, më ka torturuar psikikisht e fizikisht. Rrinte deri vonë nëpër kafene dhe kthehej i dehur. Një natë të zezë, e mallkuar qoftë, më shkroi një djalë në telefonin tim dhe, si m'i piu e zeza mendtë, ja ktheva dhe filluam t'i shkruajmë njëri-tjetrit. Më dërgoi edhe foto të tij: ishte i mirë, i bukur, i mençur dhe më bëri për vete me fjalë të buta, e që burri im, babai

i fëmijëve të mi, asnjëherë s'mi kishte thënë.

Dhe, nga ajo ditë veç sa shtoheshin sms-të e tij, por edhe unë ia ktheja gjithmonë...

Andaj, një ditë vendosëm të takoheshim për një kafe...

PREJ KAFES E DREJT E NË MOTEL!

Por, nuk përfundoi me një kafe. Pas një gjysmë ore bashkë më propozoi të shkonim në një motel në periferi të qytetit tonë. Dhe, ashtu e trullosur nga "magjia" e tij, iu dorëzova...

E, kur u ktheva në shtëpi më kaploi një mërzë, një pendim i madh...

Në ato çaste i shkrova një sms. I thashë atë që bëme ishte hera e parë dhe do të jetë e fundit, sepse po më brenë ndërgjegjja...

Dhe, pa pritur përgjigje nga ai i bëra "bllok" në telefonin tim.

PSE BURRI IM PO ATO DITË NDRYSHOI?!

Por, në ditët në vazhdim ndodhi një mrekulli në jetën time: Burri im, për çudi, nisi të sillej mirë me mua, nisi të më dojë, të kujdeset për fëmijët...

E, kjo më rri në mendje sikur ai di diçka për mua dhe nuk dëshiron ta shkatërrojë familjen...

Por, sa herë e shikoj në sy më dalin para sysh pamjet me atë djalë në motel dhe përnjëherë më prishet disponimi...

Dhe, mu për këtë fola me një hoxhë që e njoh, që kam besim në të dhe ia tregova hallin tim. Ai më tha: Harroje atë çka ka ndodhur dhe ktheju familjes me tërë qenien tënde!

Andaj, pa u hamendur, nis të veproja siç më tha hoxha dhe kam nisur të lirohem nga ndërgjegjja që më brënte...

R.

femrat E ARTA

TË ARTAT

- ★ ARIANA FEJZULLAHU
- ★ ARBNORE GEGOLLAJ
- ★ CEVAHIR MUHARREMI
- ★ KIMETE GASHI
- ★ LEONORA ELSHANI
- ★ RINA RAMADANI
- ★ VALENTINA NIKCI
- ★ VENERA MEHMETI



Arbnore Gegollaj, ylli i bukurisë dhe estetikës

Ylli i bukur, Arbnore Gegollaj, është emër i njohur në fushën e bukurisë dhe estetikës. U bë kjo që është sot falë punës dhe angazhimit të pandalshëm. Arbnorja ka studion e bukurisë dhe të estetikës "Phi Arbnore Gegollaj" në Malishevë. Dhe, falë shërbimeve cilësore e punës unike, klientela dhe suksesi nuk i mungojnë asnjëherë.

E PRIRË PËR SUKSESE

"Kam vetëbesim në aftësitë e mija për të prodhuar suksese. Jam e përgjegjshme për çdo gjë dhe përherë marrë përgjegjësi për veprimet e mija kur gjërat ndodh të shkojnë keq. Nuk pres nga forcat e jashtme të më përmirësojnë, por përherë e përmirësoj dhe avancoj veten.

Kryesisht, më përshkruajnë si femër e fortë dhe e zonja në punën që bëj. Andaj, është bukur kur njerëzit të vlerësojnë për atë që je dhe atë që përfaqëson", thotë Arbnorja.

Arbnore Gegollaj tashmë e ka vulën e suksesit dhe në sallonin e saj po drejtohen femra nga i gjithë vendi dhe jo vetëm.


Në sallonin e saj ofrohet një gamë e gjerë shërbimesh, duke nisur nga philings, phibright, microbalding, make up, hairstyle, nails, lashes, ngjyrosje etj.

Mesazhi i Arbnorës për femrat është:

"Të besojnë në vetveten, në atë që janë dhe që dinë se mund ta bëjnë. Forca e femrës është e pakrahasueshme, vetëm duhet të dinë ta përdorin siç duhet, në të mirën e tyre, të familjes dhe shoqërisë në përgjithësi".



21



**Arbnore
Gegollaj**



Ariana Fejzullahu është një nga emrat më të njohur në botën e rrjeteve sociale. Ajo ka mijëra ndjekës aktivë, të cilët e përcjellin shkaku i jetës së saj dhe i veshjeve të ndryshme e interesante.

FEMËR E KOMPLETUAR

Ariana herë është shumë moderne, herë elegante e mjaft glamuroze, por gjithmonë perfekte në stil. Ariana është gruaja e këngëtarit të njohur, Ermal Fejzullahu, me të cilin ka katër fëmijë.

Dyshja janë të martuar prej vitesh dhe vëmendja e publikut dhe ajo mediatike gjithmonë ka qenë mjaft e madhe për ta.

Bukuroshja ka një raport të shkëlqyer edhe me vjehrrin e vjehrrën.

“Shyqyr Zotit jemi shumë mirë, shihemi çdo ditë, në darka, në dreka.

Jam shumë me fat që e kam vjehrrin dhe më ndihmon shumë me fëmijët.

Jam shumë e lumtur, seriozisht, që e kam çdo moment të jetës mbështetje”, ka thënë ajo për vjehrrin e saj, legjendën e muzikës, Sabri Fejzullahu.

Ndërkohë, këngëtari ka thënë për Arianën se dashuria e saj për njerëzit është shumë e madhe.

“Është e padjallëzuar.

Asgjë të keqe nuk ka. Ajo e shfaqë dashurinë përmes buzëqeshjes së saj dhe i bën të tjerët për vete”.

Bashkëshorti i saj, Ermali, disa herë ka shprehur gjithë konsideratën e tij për bashkëshorten, duke treguar se rrita dhe edukata e fëmijëve janë meritë e saj, duke e pasur parasysh se ai vetë është gjithë kohës i angazhuar me koncerte e mbrëmje muzikore.



Ariana Fejzullahu,
zonja e artë
që shkëlqen gjithmonë



23

Ariana
Fejzullahu



Cevahir Bolukbasi – **Muharremi,** *prishtinasja e njohur* *e “Green pharmacy”*

Cevahir Bolukbasi – Muharremi është zonjë e vërtetë, e cila e vlen të prezantohet për atë që është dhe që bën.

Është prishtinase, nga një familje qytetare. Prindërit e saj, Ismaili e Hediye kanë bërë më të mirën për të bijën. Kur i ati i saj, tregtar shumë i suksesshëm, nisi të ketë probleme në vitet 2000-2001, Cevahir nisi të përballej me çdo sfidë e pengesë që i dilte përpara. Ndryshe, ajo që nga mosha pesëvjeçare e deri kur i ka bërë 17 është marrë me vallëzim.

PUNË DHE SUKSESE TË PANDALSHME

Në vitin 2008 nisi të punonte në spitalin “Bahçeci” në Prishtinë, ku dha kontributin e saj për dhjetë vjet. Cevahir Bolukbasi – Muharremi, ka kryer akademinë për estetikë në Turqi, ku është profesion-alizuar për tretmanë të ndryshëm, për makup permanent etj. I fletë katër gjuhë. Është tejet punëtore, sepse punën e ka traditë familjare.

I pëlqejnë udhëtimet dhe ndër vite ka vizituar shumë vende në Evropë dhe jo vetëm. Cevahir është e martuar me Dardanin, biznesmen i njohur dhe i kanë dy fëmijë, Malikun dhe Noanin. Cevahir tash punon në “Green pharmacy”, kompani farmaceutike me 70 pika në të gjithë Kosovën, e cila njihet si ndër më të mëdhatë dhe më seriozet në vend. Ajo thotë se puna në “Green pharmacy” është privilegj e kënaqësi dhe i jep motiv për të ecur tutje.



25

Cevahir

Bolukbasi – Muharremi



Kimete Haxhimurati
– Gashi,
nga “Tiara Fashion”,
zonja me duar të arta

Të gjithë e njohin punën e jashtëzakonshme që bën Kimete Haxhimurati - Gashi, pronare e “Tiara Fashion” në Prizren dhe Rahovec, ku vishen me veshje tradicionale të kombinuara me detaje moderne, të njohurat e skenës sonë muzikore dhe jo vetëm ato.

Klientela e “Tiara Fashion” është e gjerë, nga gjithë Kosova e Diaspora. Emra ujesh: Shkurte Fejza, Gresa Behluli, Violetë Kukaj, Shqipe Abazi, Ryva Kajtazi, Vjollca Buqaj, Mhrije Prapashtica, Violetë Kajtazi, Miranda Hashani, Vjollca Haxhiu, Lindita Kryeziu, Ylmize Tafallari, e shumë e shumë këngëtare të tjera, zgjedhin që në performancat e tyre të shkëlqejnë me kreacionet e rralla të zonjës Kimete dhe stafit të saj profesional.

Nuset shkëlqejnë me veshjet me motive kombëtare, me detaje bashkëkohore, që gjenden ekskluzivisht në “Tiara Fashion”...

ZONJA KIMETE, NJË HISTORI E GJALLË SUKSESI

Zonja Kimete tregon se me këtë profesion ka nisur të merret para 30 vitesh, më saktë në vitet më të vështira për Kosovën, kryesisht për familjen e saj të persekutuar nga regjimi i Serbisë.

Zonja Kimete, pronare e “Tiara Fashion”, thotë se Rahoveci njihet për rrushin, verën dhe vajzat e gratë e zonja që punojnë punëdore me përkushtim.

“Në familjen time nëna punonte punëdore, pastaj hallat dhe thujat e gjitha vajzat e gratë e rrethit të ngushtë në Rahovec”, thotë ajo.

Kjo zonjë, me duar të arta, tregon se në moshën 17- vjeçare e kishte punuar për herë të parë një fustan për vete, që ia pëlqyen të gjithë.

Zonja Kimete tregon se në “Tiara Fashion” po punohet në modele që janë marrë nga Muzeu i Tiranës. Puna po realizohet bashkë me një koreografe nga Tirana dhe koleksioni do të prezantohet shumë shpejt në butikët e “Tiara Fashion”.

Porosia e saj për femrat është:

“Dojeni veten! Dojeni traditën! Është mirë që secila vajzë ta ketë, së paku, një punëdore tradicionale kombëtare, që ta trashëgojë brez pas brezi”.



27

LABINOT GASHI
PHOTOGRAPHY

Kimete

Haxhimurati – Gashi



Leonora Elshani,

fotografja e njohur në Zvicër me shpirt artisti

Leonora Elshani njihet si fotografe, meqë, së fundi, është e angazhuar më tepër në fushën e fotografisë profesionale, ku e bën më të mirën. Por, ajo është përtej kësaj: është femër e shkolluar, e integruar dhe tejet e përkushtuar ndaj profesionit e familjes.

KUSH ËSHTË LEONORA ELSHANI?

“Jam e lindur në Drenas, ku përfundova shkollën fillore dhe të mesme. E, meqë isha e interesuar për shkollim të lartë, u regjistrova në UP, në degën Dizajn-Grafik dhe me sukses i përfundova studimet në vitin 2007.

Për t'u aftësuar edhe më shumë, meqë isha e pasionuar në këtë lëmi, bëra edhe një praktikë dyvjeçare në këtë drejtim.

Përvojës sime i dhashë edhe më shumë elan, duke u prezantuar në disa simpoziume dhe ekspozita të ndryshme brenda dhe jashtë shtetit të Kosovës, duke i shtuar bagazhit disa çmime si shenjë avancimi dhe suksesi”.

Leonora tregon se me fotografi ka nisur të merret që nga koha e studimeve, por që më intensivisht merret që nga viti 2015.

“Çdo person që jeton në këtë planet i ka sytë e vet unik. Secili ka “universin” e vet të papërsëritshëm.

Madje, kjo është edhe arsyeja që fillova me fotografim, duke shpresuar çdo herë që botës t'i jap kuptim ndryshe.

Për mua dizajni e edhe fotografimi janë dy krijimtari të çmuara që më mbushin plot energji dhe vullnet. Pra, unë jam dizajnere-fotografe dhe themeluese e firmës personale “ML Swiss Desing GMBH” në Cyrih të Zvicrës”.

Gjithsesi, Leonora është e impresionuar nga fotot dhe mendon që puna e një fotografi është interesante, krijuese dhe disi romantike.

“Përveç aftësive profesionale, fotografi duhet të ketë një imagjinatë të pasur dhe shije të shkëlqyer në mënyrë që fotot të jenë cilësore dhe ekspresive.

Në pamje të parë mund të duket se për të filluar një karrierë si fotograf mjafton të blesh një aparat fotografik profesional dhe të shkrepësh gjithçka.

Por, mendoj se fotografi mund të kalojë prej një hobi emocionues në një punë të preferuar e të shkëlqyer gradualisht, e kundërta e dizajnit grafik që kërkon ide dhe kreativitet”, thotë Leonora, e cila e ka studion e saj të fotografimit në Embrach të Cyrihut.

Po, ku frymëzohet artistja e fotografisë?

“Inspirimi-frymëzimi është një dhunti e Zotit, që në bazë të Krijimtarisë së Tij, ne frymëzohemi kur shohim bukuritë natyrore, krijesa të ndryshme, si: insektet, shpezët, kafshët e shumë gjëra tjera.

Frymëzimin e gjej kur unë, si fotografe, i bëj njerëzit të lumtur, e ky është kulminacioni i lumturisë sime.

Dhe, mu për këtë merrem më shumë me foto familjare”.



29

**Leonora
Elshani**



Rina

Ramadani,

ylli i muzikës live

Zëri i saj është ndër më të njohurit për ata që frekuentojnë vende me muzikë live, aty ku Rina Ramadani ja thotë këngës më së miri, krijon atmosferë brilante dhe merr admirimin e të gjithëve...

KËNGËTARE E LINDUR

Rina Ramadani këndon prej vitesh dhe tashmë është emër i konfirmuar në botën e muzikës.

Kënga e saj e parë ishte ajo me titull "Një shishe ujë", projekt i cili shënoi një fillim të mbarë për të.

Ndër vite këngëtarja ka sjellë këngë të ndryshme të shoqëruara me videoklipe dhe për secilin projekt ka bashkëpunuar me më të mirët e botës së muzikës, duke dëshmuar faktin se ajo e do cilësinë në këtë fushë.

Këngëtarja e famshme kishte edhe një bashkëpunim me Beni Baksin, këngën me titull "Zemra zemrës", që u dëgjua mjaft nga publiku.

Më 14 shkurt 2020 publikoi videoklipin "Jetoj në këtë qytet" dhe, kështu, goditi sërish. E, kjo këngë e ndjeshme ishte produkt i Avni Qahilit.

Ftesat drejt këngëtares nuk rreshtin për mbrëmje muzikore, projekte festive, spektakle e festivale.

Rina ka marrë pjesë në "Netët e klipit shqiptar" me këngën "Jetoj në këtë qytet".

Një vulë në karrierën e saj është bashkëpunimi me legjendën e këngës shqipe, Ilir Shaqirin, kur, së bashku, sjelljen këngën e titulluar "Kosovë, lule në çdo plagë", e cila jo pa arsye pushtoi zemrat e publikut. Këngëtarja ka prezantuar edhe shumë këngë në skena festivalesh, programe televizive etj.

Një gjë është e sigurt: ajo i këndon të gjitha zhanret në mënyrë perfekte, sepse është këngëtare e lindur.



31

NORIK'UKA

Rina Ramadani



“Beauty Salon Luna” - vulë suksesi e Valentina Nikqit

Valentina Nikqi është një nga emrat më të njohur shqiptar në fushën e së bukurës, e kjo falë profesionalizmit, inovacionit, kreativitetit dhe delikatesës me të cilën punon.

E lindur në Skënderaj, nga vitit 1998 jeton dhe vepron në Hameln afër Hanoverit të Gjermanisë, ku edhe u aftësua në disa linja të bukurisë dhe estetikës.

Valentina prej vitesh e ka sallo-nin e saj të njohur “Beauty Salon Luna”, ku ofron ekskluzivisht shërbime në:

- * Professional Make-up & Hairstyle
- * Body Laser
- * Microblading
- * Microneedling
- * Aqua Facial
- * Lash Extension
- * Lashliftig & Browlifting

Gjithashtu, aftëson nxënës në këto drejtime, të cilët i pajisë me certifikata që njihen në të gjithë botën.

Valentina është aftësuar profesionalisht dhe ka marrë shumë diploma e licenca të ndryshme, si në Shkollën e Kozmetikës në Hanover, SHR Germany, Academia Branko Babic, Kryolan te Dafinë Neziri etj.

Po ashtu, ka ndjekur seminare master class të ndryshme, si te Artan Kalisi, Miss Lashes etj.

Ajo ka kliente nga gjithë Gjermania dhe është ndër më të kërkuarat si Make-up artiste, ndërkohë që ka pranuar me qejf edhe një ofertë nga televizioni i madh gjerman “RTL”.

Valentina ka edhe shumë kliente shqiptare, me të cilat punon me kënaqësi, ndërkohë që së shpejti do ta zgjerojë sallonin e saj, ku do të ketë më shumë staf dhe shërbime, madje te “Beauty Salon Luna” do të ketë edhe artistë të talentuar nga Kosova.

E, për të qenë kjo që është sot, Valentina thotë se i ka ndihmuar besimi në vetvete, talenti, familja dhe bashkëshorti që e përkrahë gjithmonë.

Valentina është nënë e lumtur e tre fëmijëve dhe njihet si person tejet i shoqërueshëm.

Pasioni i saj është të shëtisë botën.



33



**Valentina
Nikqi**



Venera Mehmeti

hapë qendrën më të mirë të fitnesit për femra



Venera Mehmeti u kthye nga Gjermania, duke hapur qendrën e fitnesit "Fitmode Gym" dhe duke krijuar, kështu, diferencë në kushte, cilësi dhe komoditet. Venera Mehmeti është femër e fortë, me vizion të qartë dhe gjithmonë gati për sfidë të reja, gjë që e bën tejet të veçantë. Pos që është tejet e përkushtuar ndaj punës dhe biznesit, ajo është edhe natyrë pozitive dhe shumë e dashur nga klientet e qendrës së saj të fitnesit.

"FITMODE GYM", PALESTRA MË E MIRË NË KRYEQYTET PËR GJININË E BUKUR

Gjithmonë është koha ideale t'i përkushtohemi shëndetit, por edhe linjave, andaj është gjithmonë koha për t'u drejtuar në "Fitmode Gym", në qendrën e fitnesit të Venera Mehmetit. "Fitmode Gym" është palestra që ofron programe të ndryshme vetëm për gjininë e bukur. Ushtrimet mund të bëhen edhe me ndihmën e trajnerit personal apo stafit, i cili do u jep këshilla të ndryshme që të bëni më të mirën e mundshme për të nxjerrë në pah linjat perfekte. Venera është kthyer nga Gjermania me qëllim që të zhvillojë biznes të mirëfilltë, të kontribuojë që femrat të kenë një vend ideal për rekreacion, mirëqenie dhe arritje të linjave ideale.

Ajo organizon edhe grupe të ndryshme për vallëzimin "Zumba", si dhe ofron suplemente për heqje dhe shtim peshe, varësisht nga kërkesat e klienteve. Për më shumë, mund ta ndiqni faqen në instagram @fitmodegym ku do t'i gjeni gjitha informatat e nevojshme si dhe uebfaqen <https://fitmodegym.com>



35



**Venera
Mehmeti**

Furtuna Lushaj-Demaj

profesionistja e mjekësisë estetike që nuk ka të ndalur



Furtuna Lushaj-Demaj është estetiste mjeksore. E lindur në një familje doktor-rësh, nuk kishte si të ishte ndryshe që edhe ajo të mos e donte këtë profesion. Furtuna, tregon se që e vogël se kishte kureshtje për përdorimin e injeksioneve dhe një dashuri për njohjen e anatomisë së njeriut dhe lëmin e mjekësisë përgjithësisht.

Pasi përfundoj studimet, Furtuna ka punuar për gjashtë vite në Klinikën e dhëmbëve, me pronar Dr. Muhamet Lushaj, që është babai i saj, dy vëllezërit Dr. Arbër Lushaj, Dr. Milot Lushaj dhe motrën e saj stomatologë dhe fizioterapeute, Fatbardha Lushaj.

Duke punuar në një qytet si Deçani, ajo tregon se nuk ka qenë dhe aq e lehtë t'a bënte punën e saj, pasi paragjykimet atëherë para gjashtë vitesh ishin më të mëdha dhe veç sa kishin marrë hov ndërhyrjet estetike jo kirurgjike.

Furtuna Lushaj-Demaj, ishte femra e parë në Deçan që në ordinencën e bابت të saj ofronte edhe shërbimin për ndërhyrje estetike, si mbushja e buzëve me filler, korrigjimi i hundës, konturimi i nofullës, eliminimi i rrudhave me botulinum toxin, etj!

Furtuna thotë se rrugëtimi nuk ka qenë aspak i lehtë, ndonëse ajo nuk u ndikua asnjëherë, por me kalimin e kohës duke qenë njerzit më të informuar në lidhje me këto ndërhyrje, sipas saj kanë filluar të zbuten paragjykimet dhe sot ajo numëron numër të madh të pacientëve, si femra ashtu dhe meshkuj dhe kjo e lumturon pafund që besimi i tyre ka vazhduar edhe më tej, edhe tani që Furtuna nuk jeton më në Kosovë.



Pacientët e saj besnik caktojnë termine dhe ajo se paku tre herë në vit vjen në Kosovë dhe i kryen këto shërbime, që ofrohen në klinikën e dhëmbëve "Dr. Muhamet Lushaj", që është një ndër stomatologët profesionist më të vjetër në Deçan.

Të shtojmë se Furtuna Lushaj-Demaj tani jeton në Gjermani dhe bashkëpunon me top brendin e fillerave Juvederm si dhe me klinikat më të mira për të kryer shërbime estetike jo invazive.

Në Zvicër mund ta gjeni tek "Premium Aesthetic" ose duke kontaktuar përmes faqes në instagram: @juvederm_germany_kosova


Furtuna, është e trajnuar profesionalisht, andaj edhe klientët gjithmonë ndahen të kënaqur me rezultatet e fituara. Një pjesë prej klientëve, janë persona të famshëm dhe me ndikim në jetën publike.

Furtuna së shpejti do ta hap edhe qendrën e saj mjeksore në Stuttgart të Gjermanisë.

Padyshim më e mira !



/juvederm_germany_kosova



BOOM

*3 vajzat
më të bukura
të këngëtareve
tona*

*Të famshmit
që kanë zgjedhur
të bëjnë
jetë të thjeshtë*

*Të njohurit
shqiptarë
që treguan
publikisht
për sëmundjet
e tyre*

Ariana Krasniqi

*nga "Paris Fashion Week"
te magazinat
prestigjioze botërore*



Që në fëmijëri, që në kopsht, ajo i zgjidhte vetë rrobat dhe nuk lejonte askush t'i ndërhynte në përzgjedhje. U bënë kukullave fustane dhe kjo ishte përmbushja e saj më e madhe. Pra, bukalisht, lidhja e Ariana Krasniqit me veshjet e me stilin është e hershme. Ariana sot është dizajnatore e diplomuar dhe një nga emrat më premtues të botës së modës...

ARTISTJA AUTENTIKE E DIZAJNIT TË MODËS

E lindur dhe e rritur në Gjermani, Ariana që tre vjet jeton me partnerin e saj në Suedi. Artistja e dizajnit të modës tregon se që nga shkolla fillore e dinte se do të

*Ariana Krasniqi
nga "Paris Fashion Week"
te magazinat
prestigjioze botërore*



studionte për dizajn mode dhe kështu ndodhi. Ndoqi shkollën “Design college” në Aachen të Gjermanisë dhe më pas studimet e larta “Fashion Design Institut” në Dyseldorf.

“Tash, kur mendoj, them se e kam pasur periudhën më të mirë të jetës, ani pse ka qenë mjaft e vështirë, por koha e studimeve për më shumë se katër vjet më ka rritur si person.

Në anën tjetër, kurrë nuk e kam menduar konkurrencën, pasi luftën e kam pasur me vetveten. Jam munduar që në çdo semestër të bëja diçka të re e të bukur. Unë asnjëherë nuk kam arritur të realizoj diçka për vete, pasi isha e zënë me projektet e shkollës, aty ku jam munduar ta jap më të mirën”, thotë Ariana.

Dizenjatorja tutje tregon se synimi i saj është të jetë autentike, të sjellë produkte unike dhe profesionale. Ky profesion i jep shumë motiv, andaj shton se nuk ndihet asnjëherë e lodhur së bëri më të mirën.

“Pika ime e fortë imja është se gjithmonë kam një koncept ose mesazh në veshjet e mija, sepse moda është art. Shembulli më i mirë për këtë është edhe koleksioni im i vitit 2019 me titull “Enigmë”.

Një pikë tjetër, e që e konsideroj të fortë, është se jam e vendosur dhe e guximshme të hulumtoj llojshmërinë e stileve”.

PJESË E EVENIMENTEVE TË MËDHA BOTËRORE

Ariana Krasniqi deri më tani ka shfaqur disa koleksione dhe ka një listë të gjatë bashkëpunimesh me fotografë në Gjermani, si Anna Helm, Julian Kuhnke, Nikolo Zchachia, Arton Sefa, Chiara Bottin, etj. Dhe, fotot e koleksioneve të saj janë shfaqur në shumë magazina prestigjioze. Ariana, me koleksionet e saj, ka marrë pjesë në eventet me famë botërore “Chio Aachen” dhe në “Paris Fashion Week”.

Së fundi, ajo po bashkëpunon me misin e parë të Kosovës dhe opinionisten e “Big Brother VIP Kosova”, Afërdita Paqaradën, e cila është ikonë e bukurisë shqiptare.

Nderim Neziri



Të njohurit shqiptarë që treguan publikisht për sëmundjet e tyre

Disa nga emrat e njohur për publikun shqiptar janë përballur me sfida të vështira me shëndetin e tyre. Ja disa nga personazhet publikë që janë përballur me sfidën më të madhe...



LABINOT GASHI-LABI

Moderatori i njohur shqiptar, Labinot Gashi, ka folur mbi gjendjen shëndetësore të tij, duke bërë një deklaratë të rrallë publike mbi shëndetin. Ai ka potencuar se i është nënshtruar një operimi. Arsyeja e operimit, siç dihet, kanë qenë problemet me zemër. Moderatorin e emisionit “1 Kafë me Labin” zbuloi se ia kanë vendosur tri stenta në zemër.

MERITA HALILI

Prej kohësh përfitoj se këngëtarja e njohur e muzikës popullore shqiptare, Merita Halili, vuante nga një sëmundje. Ajo foli publikisht për sëmundjen nga e cila po kurohet...

Këngëtarja zbuloi se vuante nga Lupus, sëmundje që prek sistemin imunitar.

Kjo sëmundje është e njëjta me të cilën janë përballur shumë personazhe të njohur të televizionit, mes të cilave Lejdi Gaga dhe Selen Gomez.





SILVA GUNBARDHI

Silva iu nënshtrua një operacioni, pas një problemi me shikimin. Silva Gunbardhi, një nga emrat e njohur në skenën shqiptare, shkroi një status në "Facebook", ku kërkonte mbështetjen e fansave, ndërsa u thotë atyre të lutën për të.

Statusi prekës i këngëtares nxori në pah anën njerëzore të çdo të famshmi ose të famshme, e që, pavarësisht se duken si të pakapshëm, i vuajnë problemet njësoj si të gjithë.

BIG MAMA

Fillimisht, për të u fol se vuante nga sëmundja e kancerit, por këngëtarja vendosi t'i sqaronte një herë e mirë të gjitha thashethemet.

Ajo tregoi se iu nënshtrua një operacioni për heqjen e tëmthit, prej të cilit vuante prej kohësh. "Isha në Turqi, fillimisht për një pjesë të emisionit tim, e më pas më dolën edhe disa punë e vështirësi të tjera.

Në një klinikë kirurgjikale kam operuar lukthin, domethënë e kam zvogëluar atë. Por, gjatë analizave, mjekët kanë konstatuar se duhej të hiqja edhe tëmthin", sqaroi këngëtarja në janar të vitit 2017.



FLORI MUMAJESI

Vite më parë, njoftimi i tij i shokoi fansat e këngëtarit, kur ai lajmëroi përmes një statusi në "Instagram" se kishte probleme me shëndet, nga dhimbjet që kishte në kraharor, ndaj ishte i detyruar t'i anulonte të gjitha koncertet.

"Nuk di a duhej ta bëja këtë postim apo jo, por e ndjej detyrim për ata njerëz që nuk kanë mundur të më shohin në koncert. Kam dy ditë që luftoj me dhimbjen në kraharor për të mos munguar, për të qenë aty me ju deri në minutën e fundit... Por, nuk ja dola dot dhe kjo është dhimbja më madhe...

Doktorët më kanë dhënë afat nga 3 deri në 6 javë për t'u rikuperuar, por unë shpresoj se do të bëhem mirë më shpejt.

Shpresoj mos t'ju shqetësoj ky postim! Nuk më pëlqen ta dramatizoj më shumë, është lëndim i kockës brenda në krahë, që duhet kaluar me energji pozitive.

Ju dua", shkruante Flori.

N.

Të famshmit që kanë zgjedhur të bëjnë jetë të thjeshtë

Pavarësisht fitimeve marramendëse për shkak të profesionit të tyre, shumë personazhe publikë njihen për thjeshtësinë e tyre. Më poshtë janë renditur disa VIP-a që bëjnë jetë të thjeshtë, të cilët njihen edhe për bamirësitë e shumta që kanë bërë për t'u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë.

XHENIFER LAVRENCE

Xhenifer Lavrencve ishte aktorja më e paguar në botë më 2015 dhe 2016, me të ardhura vjetore prej 52 dhe 46 milionë dollarë.

Dhe, përkundër të ardhurave të larta, është vlerësuar si shembull për jetën e saj modeste.

Në një intervistë që ka dhënë para disa kohësh, rrëfeu se ka jetuar gjithmonë në një apartament të vogël në Nju-Jork dhe në një tjetër të vogël kur ndodhej në Los Anxhelos.

Ajo njihet dhe për bamirësi të shumta që ka bërë.

Në vitin 2016 aktorja dhuroi 2 milionë dollarë në Spitalin e Fëmijëve Kosair në Louisville.



KEANU REVES

Reves thotë se paratë janë gjëja e fundit për të cilën mendon.

“Mund të jetoj me atë që kam bërë për disa shekuj”, thotë. Dhe, kur Reeves po udhëtonte në Los Anxhelos në mars të vitit 2018, avioni u detyrua të ulej në Bakersfield, shkaku i një defekti. Andaj, nuk priti që avioni të riparohet, por mori një furgon për ta dërguar atë dhe udhëtarët e tjerë në qytet.

ROBERT PATINSON

Robert Patinson është një nga aktorët më të paguar në botë. Në një intervistë thotë se gjatë viteve të fundit, pavarësisht se kishte të ardhura të mira, preferon të jetë sa më i thjeshtë kur bëhet fjalë për shumicën e gjërave.

Për më tepër ai nuk harron të bëjë bamirësi.

“Kam qenë donator dhe një mbështetës. Dhe, tani mezi pres t'i bashkojë përpjekjet, kështu që së bashku mund t'u japim një mundësi edhe më shumë fëmijëve dhe të rinjve në të gjithë globin,” tha ai gjatë një fushate jofitimprurëse.





MARK ZUCKERBERG

Që nga viti 2010, Mark Zuckerberg, është vlerësuar si një nga njerëzit më të pasur dhe me ndikim në botë.

Por, pavarësisht të ardhurave të larta, ai njihet si person që bën jetë modeste. Për shembull, ai është fotografuar duke përdorur një "Honda Fit" dhe një "Volksvagen Golf"!

BLAKE LIVELY DHE RYAN REYNOLDS

Ky çift mund të jetë një model shembull për shumë kënd. Janë martuar në vitin 2012 dhe i kanë 3 fëmijë.

Janë të famshëm, të suksesshëm dhe mund të përballojnë një jetë shumë luksoze, por familja jeton në Pound Ridge, një qytet i vogël në shtetin e Nju-Jorkut.



LEONARDO DI CAPRIO

Leonardo Di Caprio u përfshi në listën vjetore të aktorëve më të paguar të "Forbes" nga viti 2010 deri në 2016.

Përpos pasurisë marramendëse, ai ka zgjedhur të bëjë jetë normale. Për shembull, u fotografua duke ndihmuar një turist që kishte humbur në një ditë me shi në Manhattan.

Di Caprio njihet edhe për bamirësi. Në vitin 2020, fondacioni i tij, dhuroi 3 milionë dollarë në përpjekjet për lehtësimin e situatës së shkaktuar nga zjarret në Australi.

"Boom"

3 vajzat më të bukura të këngëtareve tona

Këngëtarët shqiptarë janë pjesë e pandashme e medieve rozë. Disa për jetën luksoze që bëjnë, disa për skandale, e disa të tjerë në momente të lumtura familjare. Sepse, tashmë gjithçka është transparente në rrjetet sociale... Albiona Muqiqi, Engjëllusha Salihu dhe Rozafa Mustafa, pa dyshim, janë vajzat që kanë pushtuar shtypin rozë...



ALBIONA MUQIQI

Është vajza e këngëtarëve të njohur Nusret dhe Merita Muqiqi, e cila u bë e njohur në sajë të prindërve. Është mjaft e komentuar në mediet rozë falë bukurisë së veçantë që ka. Biondja është mjaft aktive në rrjetet sociale, duke pozuar foto nga më të ndryshmet. Ajo, gjithashtu, është bërë pjesë e tregut muzikor.

ENGJËLLUSHA SALIHU

Prej vitesh Engjëllusha është bërë pjesë e skenës tonë muzikore. Ajo është vajza e artistes së madhe të muzikës popullore, Shyhrete Behlulit.

Siç duket, bukurinë dhe talentin për këngë e ka trashëguar nga e ëma.

Se është e bukur, flasin edhe fotot e saj...



ROZAF KRYEZIU

Rozafa është vajza seksi e këngëtarëve mjaft të njohur Shkumbin dhe Mimoza Kryeziu. Është bërë e njohur për publikun kur ishte maturantja më e dalluar për pamjen e saj.

Rozafa, vajzë e re, por tejet e bukur, nuk ka shfaqur interesim për botën e muzikës.

Me linjat trupore perfekte ua ka fituar zemrën shumë ndjekësve të saj.

D. H.



allure®

B E A U T Y

**CFARË VJEN
ME PLAKJEN,
IKËN ME
PLEXR!**

VETËM NË ALLURE BEAUTY



Nëse kërkohet që vajza të jetë e virgjër, pse të mos jetë edhe djali?!

Një pjesë e madhe e vajzave humbjen e virgjërisë e marrin si kërkesë e të dashurit, e jo edhe e dëshirës së tyre, që do të thotë se vajzat shqiptare e humbin virgjërinë pa dëshirën e tyre. Çka mendojnë vajzat e reja në këtë temë?

**ALTINA, 20 VJEÇE:
TA RUASH VIRGJËRINË
ËSHTË ÇËSHTJE INDI-
VIDUALE**

- Ajo që më shqetëson shumë është fakti se vajzat e virgjëra e reklamojnë sa të mundin këtë gjendje të trupit të tyre dhe pretendojnë se janë me karakter të fortë, sepse arrijnë të përmbahen.

Të jesh e virgjër dhe ta ruash virgjërinë është e drejtë individuale, por kjo nuk është tregues i ndershmërisë dhe t'i shikosh të tjerat me përbuzje.

E, sa u përket djemve, ata që e vlerësojnë një vajzë vetëm se është e virgjër, janë dhelparakë!

E, kur flasim për virgjërinë e femrave, pse të mos flasim edhe për virgjërinë e djemve?

Edhe djali duhet të jetë i virgjër kur të martohet. Pse jo?! Çka ka të keqe këtu?!

**VALËVITA: 24 VJEÇE:
KUR DALLAVERAXHIU
SHITET I MORALSHËM!**

- Pavarësisht se jemi në shekullin XXI dhe numri i vajzave të virgjëra po zvogëlohet dita-ditës, i uroj të gjitha ato vajza që kanë arritur ta ruajnë virgjërinë.

Mendoj se nuk është mirë për një djalë t'i ketë pasur 7-8 dashnore para martesës dhe nga vajza që martohet të kërkojë të jetë e virgjër, sepse vetë s'ka lënë gjë pa bërë e tash shitet i moralshëm!

Pse edhe ai të mos jetë i virgjër në natën e parë të martesës?!

Pra, nëse i tilli kërkon me çdo kusht që va-

jza me të cilën martohet të jetë, gjithsesi, e virgjër, ai është idiot, i poshtër, dallaveraxhi.

**VIGJILENTJA: 18 VJEÇE:
VIRGJËRINË IA FALI
DHËNDRIT NË NATËN E
PARË TË MARTESËS!**

- Djemve të sotëm u ka humbur rruga në oborr! Ka të tillë që mendojnë se më s'ka mbetur asnjë vajzë e virgjër! Të tillët budallenj mendtë i kanë vetëm te virgjëria! Por, e kanë gabim, sepse njëra ndër ato që janë të virgjëra jam unë.

Kam pasur shumë kërkesa që të dilja me djem, por nuk e kam parë asnjë si serioze. Më shumë ishin kërkesa për kalim të kohës...

Andaj, nuk dua të gabo, sepse kam vendosur virgjërinë t'ia falë vetëm atij që martohet dhe pikë.

**SI TA PËRMBYLL
KËTË TEMË?**

Kështu është jeta jonë kosovare, sepse djemtë tanë janë ende primitiv...

D. Haxhaj



Ass. Prof. Dr. **Berk Arapi**
Specialist i Kirurgjisë Vaskulare

4-5
SHKURT

LARGIMI I VENAVE VARIKOZE PA NDËRRHYRJE KIRURGJIKE

LARGIMI I VENAVE ME LASER

Procedurë që zgjatë vetëm **40 min** dhe kryhet nën anestezion lokal. Menjëherë pas procedurës ju lironeni për në shtëpi dhe vazhdoni aktivitetet normale



Isak Njutoni ka parashikuar fundin e botës më 2026!

Isak Njutoni u lind më 4 janar të vitit 1642. Bëri revolucion shkencor në shekullin XVII, me themelet që i vuri Fizikës moderne. Megjithatë, bëri jetë të vështirë dhe me shumë fatkeqësi. Isaku njihet edhe si parashikues. Ka parashikuar fundin e botës në vitin 2026. Por, a do të ndodhë një gjë e tillë?

Ndryshe nga popujt e tjerë evropianë, gjatë tërë historisë së tyre shqiptarët nuk kanë nxjerrë profetë. Sepse, nuk përmenden në kronika figura shqiptarësh që janë vetëshpallur si profetë, për të ndikuar në forma paralajmëruese, me ide apokaliptike, të ardhmen apo epokat e historisë së tyre.

Në popuj më të mëdhenj si francezët, anglezët dhe gjermanët shfaqja e profetëve ka qenë diçka e rëndomtë, ushtrimi publik i një lloji zhanri, të ngjashëm me fallxhorët, parashikimin e fatit etj.

Përgjithësisht, profetët shfaqen në epoka krizash. Janë krizat që i mishërojnë artikulet e tyre, të çuditshme, fantazmagorike, të besueshme ose dhe të pabesueshme.

Po ja që shqiptarët, për arsye të mos arsyeve që nuk dihen, ose që nuk ka

çarë kokën askush për t'i studiuar, nuk shquhen se kanë nxjerrë profetë as për veten e tyre e as për popujt e tjerë. Për të larguar dhe shmangur çdo keqkuptim, dua të them se unë nuk besoj tek profecitë.

Para disa vitesh lexova me përkushtim librin e një profesori të Universitetit të Izraelit, për dorëshkrimet sekrete të Isak Njutonit, një nga titanët më të mëdhenj të shkencës të të gjitha kohërave.

Isak Njutoni qe edhe një mistik i madh. Duke studiuar sipas principeve të numerologjisë frazat shumëkuptimshme të Apokalipsit, ai ka profetizuar fundin e botës, afërsisht nga viti 2026. Dorëshkrimet e Njutonit, të bazuara në kabalistikë, ende nuk janë publikuar, por mbi to janë bërë shumë studime nga shumë dijetarë të planetit.

Mikom Zeqo



Kompania e ndërtimit Ass-Bau

tashmë edhe në Kosovë, fillon ndërtimi i villave luksoze

Tashmë edhe në Kosovë investitorët gjermanë Alexander dhe Tamara Stoppel në bashkëpunim me vëllezërit nga Vitia Abaz dhe Gazmend Idrizi po sjellin projektet e vilave luksoze në lartësinë 1450 m mbi nivelin e detit, një zonë mahnitëse turistike në fshatin Debeldeh të Vitisë.

Me përvojë 20 vjeçare në fushën e ndërtimit, fillojnë projektet edhe në Kosovë.

Villa të kategorive të ndryshme që ofrojnë komoditet të plotë, të vendosura në fshatin Debeldeh të Vitisë janë vërtetë inovacion në fushën e ndërtimit, gjithçka frymëzuar nga natyra.

Gjelbërimi, ajri i pastër dhe pamja e bukur malore, janë vetëm disa nga mrekullitë që së shpejti do t'i përjetoni në villat moderne.

Poashtu, risitë lidhur me villat Assbau mund t'i ndiqni edhe në instagram në @assbaukosovo si dhe uebfaqen www.assbau-kosovo.com

Për me tepër informacion na kontaktoni në numrat në ekran. Adresa: Rr, Elena Gjika, Viti Kontakti +4917656563795 +383 (0) 48 455 333 villamalore@ass-bau.com





DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

A family consisting of a man, a woman, and two young girls are walking together on a paved path. The man is on the left, wearing a green sweater and tan pants, holding the hand of the first girl. The woman is on the right, wearing a light-colored jacket and jeans, holding the hand of the second girl. The two girls are in the middle, wearing pink and red sweaters. They are all smiling and looking towards each other. In the background is a modern, multi-story apartment building with a dark facade and large windows. The scene is set in autumn, with trees having orange and yellow leaves.

Kompleksi Ulpiana Center – Lipjan



**Kompleksi
Dardania – Prizren**

A large, three-dimensional white '10%' is the central focus of the lower half of the image. It is placed on a grassy field with some fallen autumn leaves. In the background, there are modern apartment buildings under a sunset sky. The overall scene is peaceful and inviting, suggesting a high-quality living environment.

10%

ZBRITJE



3 shenjat e Horoskopit që mërzhiten për gjënë më të vogël

Disa njerëz kanë shumë durim, ndërsa të tjerë irritohen shumë lehtë. Ata zemërohen për gjënë më të vogël. Edhe pse nuk janë të këqij dhe s'shkaktojnë probleme, shpërthimet e tyre shpesh na vënë në siklet dhe turpërojnë. Nëse edhe ju keni një person të tillë në jetën tuaj dhe pyesni veten pse ai është kaq nervoz, ndoshta shenja e tij e horoskopit do t'ju japë përgjigjen.

DASHI

Dashi e do lirinë dhe zemërohet shumë kur dikush përpiket ta kufizojë ose ta kontrollojë. Fjalët e tyre kur bëhen nervoz janë mjaft të ashpra, ndërkohë që mezi i kontrollojnë emocionet kur debatojnë.

DEMI

Kokëfortë dhe gjaknxehtë, Demi bezdiset lehtësisht. Kur vendosin për diçka, mendimi i tyre nuk ndryshon dhe ata do t'i përmbahen, edhe nëse rezulton se është e gabuar. Kur zemërohen veprojnë në mënyrë impulsive edhe pse më vonë mund të pendohen.

AKREPI

Ata mund të dinë diçka dhe presin që personi tjetër ta zbulojë atë, vetëm që të mund të hakmerren. Megjithatë, kur është i zemëruar nuk ka asgjë që e pengon. Do të bëjë gjithçka për t'ia dalë dhe nëse dikush e kundërshton atë që thotë, nuk do të hezitojë t'ia tregojë.



Revolucion në dobësim

Qendra e dobësimit "Shkenda Dubova" është ndër bizneset e vetme kosovare me qendra në dy kontinente të botës.

Përmes rezultateve konkrete e shumë të suksesshme të klientëve, dhe për shkak efektivitetit të kësaj teknologjie, qendra arriti zgjerimin edhe jashtë vendit. Qendrat e dobësimit Shkenda Dubova tani operojnë në: **Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Gjermani, Zvicër dhe Belgjikë, Norvegji, Angli e Amerikë.**

Programi për humbje peshe është i testuar, verifikuar dhe certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare.



Në qendrat e dobësimit ofrohet shërbim i veçantë që ndodhë në disa procese, përmes aparaturave të teknologjisë më të re në këtë fushë. Përmes shërbimit të dobësimit, ofrohet djegia e kalorive, nxitja e metabolizmit, shkrirja e masës dhjamore dhe trajtimi i thellë te saj.

Humb
peshe

Detoksifikohu



Relaksohu

Balanco
shëndetin

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Do të ndahemi, apo?

Zonja magjistare, jam 44-vjeçare, me profesion doktoreshë, punoj prej shumë vitesh, e pamar-tuar. Para një viti fillova një lidhje me një person nga Tetova, e që jeton në Zvicër. Dukej se më don-te, bisedonim gjatë dhe arsyeshëm dhe u takuam disa herë, për të filluar, më në fund, rregullimin e dokumenteve për atje. Por, në këtë fazë filluan edhe problemet tona. Ai shprehte shumë xheloz, më akuzonte e më ofen-donte, duke më etiketuar se e tradhtoja. Kjo mënyrë e sjelljes së tij vazhdoi për disa muaj dhe para pak ditësh më tha se do të ndahet.

Si të sillem me këtë per-son?

“Zemër e thyer”

Përgjigje:

Ju jeni njohur me një per-son i cili nuk krahasohet

me mentalitetin tuaj in-telektual dhe psikologjik. Unë te ai shoh gatishmëri-në për ndarje. Ai është sjell mirë në kohën sa nuk ka filluar procesi i rregullimit të letrave tua për të shkuar në Zvicër. Këtu ka dal pengesa te ai dhe pa-mundësia me ua thënë të vërtetën.

Andaj, ai edhe e luan ro-lin e një të krisuri. E ka gjetur metodën e akuz-imit e të xhelozisë, gjë që ka mundësi të jetë reale vetëm kjo e fundit. E, përmes kësaj sjelljeje ai ka llogaritur të të ftoftë ndaj tij dhe ta ndryshosh bindjen për të. Shoh qartë se qëllimi i tij nuk është serioz.

Pse nuk na ecin gjërat mbarë?

Zonja magjistare, jam një zonjë rreth të pesëdh-jetave. Prej kur jam mar-tuar, pra qe 26 vite, gjërat

nuk na ecin mirë e mbarë, sepse kurrë nuk kemi pa-sur jetë të mirë, edhe pse jemi në Perëndim. Ende nuk kemi as shtëpi tonën. Vjet kemi filluar ndërti-min e një shtëpie, por, siç thotë populli, nuk i kemi marrë këmbët akoma. Burri qe 12 vite kërkon pension, por të paguajmë avokat nuk kemi mundësi. Nuk di si do të vazhdojë jeta jonë...

“Duke pritur”

Përgjigje:

Sistemi i vlerave perëndi-more bazohet mbi punën dhe fitimin nga puna, e që juve u ka munguar. Nuk është në pyetje magjia, por e keni lënë anash punën dhe kjo ka bërë të mos keni bazë ekonomike. Gabimi është te qasja juaj dhe duhet ta ndryshoni këtë gjendje, duke i lënë me një anë ekzistencën nga pensionimet e hershme, që edhe ashtu nuk u bën nder e as progres ekonomik.

A do të ndryshojë vjeh-rra e vajzës?

Magjistare e nderuar, jam një nënë me një problem prej shumë vitesh. Vajza ime e do një djalë qe 7-8 vjet. Por, qe dy vjet është martuar, edhe pse nuk rri tërë kohën në shtëpinë e burrit shkaku i vjehrrës. Dua përgjigje prej teje se a do të ndryshojë vjehrra

e vajzës, bile ndaj djalit të vet, sepse nuk kam parë nënë të tillë për djalin e vet?

A do t'i lë rehat djalin dhe nusen dhe çka do të ndodhë me vajzën time?

"Nëna e brengosur"

Përgjigje:

Aktualisht, sot pak nuse i duan vjehrrat. Vjehrrat luftojnë që shtëpia të ketë një traditë dhe krenari dhe nusja të jetë e lavdëruar nga rrethi e masa. Kjo është dëshirë e vjehrrave, por për nuset dhe nënat e nuseve nuk tingëllon kështu.

Nuk ka nënë që ia do të keqen djalit të vet, por nëse nusja e tepron, atëherë vlen fjala popullore "për inat të resë...".

Unë nuk shoh se vjehrra është armike e djalit të vet, por normale është se as nuk do të ketë komandant në shtëpi. Nuk dua të paragjykoj fajtorin, por ju, para së gjithash, duhet t'i vlerësoni gjërat ashtu si qëndrojnë dhe të keni dozë vetëkritike edhe për vajzën tuaj, sepse faji gjithnjë është jetim.

A do t'më përsëritet aborti?

Përsëritet e nderuara magjistare, jam B., 24-vjeçare, e martuar që

tre vjet. Jetën martesore e kam të mirë, por më është thyer zemra, sepse më ka vdekur fëmija në bark në muajin e pestë të shtatzënisë dhe kam frikë se do t'më ndodh përsëri e njëjta gjë. Më kanë thënë se kam infektion.

A të filloj përsëri një shtatzëni të re?

"Arni 15"

Përgjigje:

Sugjerimi im është ta evitoni infeksionin gjinekologjik dhe vetëm pasi të konstatohet se infeksioni është eliminuar, të filloni shtatzëni të re dhe nuk do u përsëritet asgjë e keqe. Trajtohuni te gjinekologu, sepse jeni rast për shërim...

A është fati im personi që e dua?

Përsëritet zonja magjistare, jam A., nga Ferizaj, 23-vjeçare. Që një vit jam në lidhje me një djalë.

Dua t'më tregoni nëse personi që jam në lidhje me të është fati im apo jo, sepse e dua shumë?

"A"

Përgjigje:

Duhet t'i sqaroni gjërat me të dhe jo të futeni në lidhje e pastaj të mos gjeni shtegdalje shpirtërore.

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Nëse ju duheni, apo nëse dashuria juaj është reciproke, ai do t'u propozojë fejesë. Por, nëse ai nuk e bën këtë, ti duhet ta iniciosh fejesën. E, nëse ai nuk përgjigjet pozitivisht, tërhiq me kohë. Kjo është e tëra dhe nuk ka koment tjetër.

Mos ëndërro në qiell e këmbët në tokë...

Jam numri 3. Cilat karakteristika i kam?

Jam një vajzë 25-vjeçare, i takoj numrit të fatit 3. Dua të di se çka është karakteristikë imja në jetë?

"Nr. 3"

Përgjigje:

Bota jote i pushton të tjerët shpejt dhe keni kreativitet artistik e imagjinativ. Keni shpirt emocional, sens për humor dhe lehtë i relaksoni situatat. Mbi të gjitha, e doni lirinë.

Ke shumë pasion për dashurinë dhe u pengon vetmia. Keni të meta, sepse kundërshtoni edhe pa fakte dhe nuk dorëzoheni edhe kur nuk e keni mirë.



SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend

| SHERWOOD
exclusive kemer

| SHERWOOD
exclusive lara

| SHERWOOD
Dreams Resort

| **3UE**
TUI BLUE
Belek

| SHERWOOD
Premio Hotel

| GREENWOOD
Kemer Resort

| GREENWOOD
Suites Resort

📱 sherwoodresorts 📱 greenwoodhotels

www.sherwoodhotels.com.tr www.greenwoodhotels.com.tr